



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.18.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË KËSHILLIT
GJYQËSOR TË KOSOVËS PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31
DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra e Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Liridona Berisha Kelmendi (udhëheqëse ekipi), dhe Laureta Matoshi Pozhegu, Mjellma Dibra Morina, Mimoza Morina Kelani (anëtarë të ekipit), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit, Ramadan Gashi.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	21
5 Qeverisja e mirë.....	21
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	24
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme	27
Shtojca III: Letërkonfirmimi	32

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 02/10/2017.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra e Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Theksimi i çështjes

Tërheqim vemendjen tuaj për faktin se vlera e detyrimeve kontigjente e shpalosur në PVF ishte nënvlerësuar. Me tutje, KGJK kishte bërë keqklasifikim të shpenzimeve duke paguar nga kategoria e investimeve kapitale për shpenzimet që për nga natyra i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore



Përgjigja e Menaxhmenti të Këshillit Gjyqësor të Kosovës- auditimi 2017

Menaxhmenti ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresoj rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës. Ne kemi analizuar veprimtarinë e organizatës se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e AP-së.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse..

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (të kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregullore MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Ne kemi kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

- Detyrimet kontigjente në vlerë prej 9,143,704€, nuk ishin prezantuar në PVF, siç kërkohet me Rregulloren e MF-it nr.01/2017 për raportim financiar vjetor. Këto detyrime ishin si rezultat i padive nga palët (personat e dëmtuar) ndaj KGJK-së, të grumbulluara vit pas viti (dëmit material, pagave dhe kompensime tjera);
- Përveç kësaj, KGJK kishte bërë pagesa nga kategoria e investimeve kapitale në shumë prej 205,100€, për shpenzimet të cilat sipas natyrës i takojnë kategorisë mallra dhe shërbime. Vlen të sqarohet se, kjo vlerë ishte e aprovuar me tabelat buxhetore të Buxhetit 2017 për investime kapitale „Riparimi dhe mirëmbajtja e objekteve të gjykatave (957€)” dhe „Blerja e pajisjeve të IT në bashkëfinancim me projektin SMIL (204,143€)”. Projektet e paraqitura në tabelë, nuk përmbushin kushtet të trajtohen si projekte kapitale, dhe gabimet kanë të bëjnë me planifikimet fillestare nga KGJK dhe aprovimet jo adekuate nga ana e MF. Opinioni ynë nuk është i modifikuar në lidhje me çështjet e përmendura më lart.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Zyrtari Kryesor Financiar është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, si dhe është përgjegjës për kontrollin të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtorit i SKGJK është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Këshillit Gjyqësor të Kosovës.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbulojë çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo

gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga KGJK kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 03/2010, nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Pasqyrat Nëntëmujore me kohë;
- Planin e Prokurimit për vitin 2017; dhe
- PVF janë përgatitur me kohë dhe nënshkruar nga ZKA dhe ZKF.

Në kontekst të kërkesave për raportim, ne nuk kemi identifikuar ndonjë parregullsi.

Nga aspekti i cilësisë, PFV-të nuk përmbanin gabime dhe mangësi informatash, me përjashtim të çështjeve të detyrimeve kontigjente dhe keqklasifikimeve të shpenzimeve për të cilat ne e kemi theksuar opinionin.

DEKLARATA E BËRË NGA MENAXHMENTI I KGJK-së

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, është e saktë dhe e drejtë, për shkak se gjatë auditimit nuk janë identifikuar gabime materiale, përveç çështjes së paraqitur të theksimi i çështjes.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e mësipërme rekomandimet tona janë:

Rekomandimi 1 Drejtori i SKGJK duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i adresuar shkaqet në Theksim të Çështjes së opinionit të auditimit dhe para se pasqyrat të dërgohen në MF, ato t'i nënshtrohen një rishikimi gjithëpërfshirës në lidhje me përmbajtjen dhe saktësinë e tyre, me theks të veçantë shpalosjen e detyrimeve kontigjente.

Rekomandimi 2 Drejtori i SKGJK duhet të shtoj kontrollet gjatë planifikimeve buxhetore, në mënyrë që të eliminohen gabimet në klasifikimin e shpenzimeve përmes sigurimit të buxhetimit/shpenzimit dhe raportim të drejtë të tyre.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron punën e detajuar të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Si pjesë e kësaj, ne konsiderojmë menaxhimin e buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

KGJK në përgjithësi ka kontrolle në raport me obligimet statutores të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera. Megjithatë, sfidë për institucionin edhe me tutje mbetet menaxhimi i pagave dhe shtesave dhe menaxhimi i pasurive.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, si dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	21,797,640	21,793,948	19,602,402	19,528,929	18,791,104
Granti i Qeverisë -Buxheti	20,593,782	19,956,808	19,411,317	18,872,482	17,643,133
Të hyrat vetjake ²	1,203,858	1,203,858	176,743	656,447	1,147,971
Të bartura nga viti paraprak ³	-	623,753	5,342	-	-
Donacionet e jashtme	-	9,529	9,000	-	-

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar me vendime të Qeverisë për 3,692€. Ky zvogëlim është si rezultat i moszbatimit me kohë të marrëveshjes së Brukselit për Gjyqësorin e Republikës së Kosovës, si dhe mos rekrutimit të stafit në Gjykatën Themelore në Mitrovicë.

Në vitin 2017, KGJK ka shpenzuar 19,602,402€ apo 90% të buxhetit final, me një zvogëlim prej 7% krahasuar me vitin 2016. Megjithatë, realizimi i buxhetit mbetet në nivel të kënaqshëm.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	21,797,640	21,793,948	19,602,403	19,528,929	18,791,104
Pagat dhe Mëditjet	16,464,561	16,358,058	14,622,640	14,016,443	13,511,947
Mallrat dhe Shërbimet	3,813,079	3,884,858	3,545,741	3,932,056	3,601,422
Shërbimet komunale	450,000	448,500	396,629	378,092	419,043
Subvencionet dhe Transferet	250,000	392,532	385,471	368,212	380,288
Investimet Kapitale	820,000	710,000	651,922	834,126	878,404

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar në kategorin e pagave dhe mëditje ishte zvogëluar për 106,503€, me vendim të qeverisë. Përderisa, teprica e mjeteve financiare në fund të vitit ishte 1,735,418€, kjo për shkak të mos zbatimit të marrëveshjes së Brukselit për

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave

² Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

³ Të hyrat vetjake të KGJK të pashpenzuara në vitin paraprak të bartura në vitin aktual.

Gjyqësorin ku ishin të paraparë të punësohen 48 gjyqtar dhe 115 staf administrativ për pakicën serbe. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 89%;

- Buxheti final i mallrave dhe shërbimeve në raport me buxhetin fillestar, ishte rritur për 71,779€ me vendim të Qeverisë⁴. Arsyeja e rritjes ishte për pagesën e avokatëve, ekspertëve dhe gjyqtarëve porotë në Gjykatën Themelore në Gjilan dhe Ferizaj. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 91%;
- Buxheti final për komunalitet ishte zvogëluar për 1,500€, me vendim të Qeverisë⁵. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 88%;
- Buxheti final në raport me buxhetin fillesat në kategorinë subvencione dhe transfere me vendim të Qeverisë⁶, ishte rritur për 142,532€. Mjetet financiare janë transferuar nga kategoria e Investimeve kapitale (projekti 15248-Ndertimi i objektit të Gjykatës Themelore Graçanicë) në kategorinë e subvencioneve 110,000€, si dhe mjetet e tjera financiare në shumë 32,276€ dhe 256€ janë shfrytëzuar nga të hyrat e bartuar. Arsyeja e rritjes së kësaj kategori ishte për kompensimin e të dënuarve pa bazë. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 98%; dhe
- Buxheti final për investimeve kapitale ishte zvogëluar për 110,000€. Këto mjete financiare janë transferuar në kategorinë e subvencioneve dhe transfereve. Realizimi i buxhetit për këtë kategori ishte 92%.

3.2 Të hyrat

Ne i kemi shqyrtuar të hyrat e arkëtuara si burim i fondit buxhetor. Kjo është paraqitur në tabelën e mëposhtme:

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	1,203,858	1,203,858	7,708,641	8,051,611	8,087,041
Totali	1,203,858⁷	1,203,858	7,708,641	8,051,611	8,087,041

Me ligjin e buxhetit për vitin 2017, KGJK-së ju është lejuar shfrytëzimi i të hyrave prej 1,203,858€, ndërsa pjesa tjetër transferohet në Buxhetin e Kosovës.

KGJK realizon të hyra nga taksat në gjykata, gjobat në gjykata dhe trafik, si dhe të hyrat nga shitja e pasurisë. Për vitin 2017 kishte planifikuar të hyrat në vlerë 7,310,008€⁹, ndërsa ishin mbledhur 7,708,614€, dhe nga kjo shihet një tejkalim i planit të të hyrave për 398,606€. Mirëpo, nëse

⁴ Vendimi i Qeverisë nr. 02/22 i datës 27.12.2017.

⁵ Vendimi i Qeverisë nr. 02/22 i datës 27.12.2017.

⁶ Vendimi i Qeverisë nr.10/19 të datës 15.12.2017.

⁷ Vlera totale e të hyrave 1,203,858€ janë lejuar të shpenzohen për nevojat e KGJK-së.

⁹ Plani i të hyrave nga KGJK-ja për vitin 2017.

krahasojmë këto të hyrat me të hyrat e vitit të kaluar (2016) kemi një rënie të të hyrave për 342,970€.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat dhe shtesat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative.

Numri i aprovuar i të punësuarave në KGJK ishte 2,159¹⁰, ndërsa numri i të punësuarve në fund të vitit ishte 1,968 punonjës. Ne kemi rishikuar listat e pagave si dhe kemi krahasuar të dhënat e prezantuara nga Thesari, SIMFK dhe prezantimin e tyre në PFV. Po ashtu, kemi rishikuar nëse punonjësit janë paguar sipas kontratës. Nga testimet tona identifikuam çështjet si në vijim:

¹⁰ Me ligj të Buxhetit janë të aprovuar mirëpo nuk ju ishin alokuar mjetet financiare.

Çështja 3 – Kompensimi i anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Komisioneve

E gjetura Neni 3 i U/A për kompensimin e anëtarëve të Këshillit Gjyqësor dhe Komisioneve, përcakton se pjesëmarrja brenda ditës në takime të Këshillit Gjyqësor është 70€, ndërsa në Komision 50€. Në rastet kur nevojitet pjesëmarrja në dy takimet brenda ditës atëherë pagesa bëhet vetëm për takimin e Këshillit Gjyqësor në vlerë prej 70€.

Nga testimi i pagesave retroaktive të anëtarëve të komisioneve në panel të caktuar me vendim nga Këshilli, për të cilat evidentohet prezenca e tyre me rastin e mbajtjes së seancave, në një rast që nuk ishte i caktuar me vendim anëtar i komisionit, mirëpo ishte kompensuar në vlerë 250€, dhe për me tepër pagesa për muajin mars si anëtar i komisionit nuk ishte arsyetuar.

Po ashtu, në një rast kemi vërejtur se anëtarët e Këshillit Gjyqësor dhe të komisioneve që kanë marrë pjesë brenda ditës në takime të ndryshme dhe se ishin paguar për të dy takimet. Anëtarët e këshillit gjyqësor dhe të komisioneve janë kompensuar me tepër në vlerë 250€ (secili nga 50€).

Për të dy raste KGJK kishte ndërmarr masa dhe mjetet për dy anëtarët e komisioneve ishin kthyer në buxhet në vitin 2018.

Rreziku Kontrolllet jo të duhura në kompensimin e anëtarëve në këshill dhe komisione, rrisin rrezikun që pagesat e tilla përveç që nuk janë në përputhje me kërkesat rregullative, mund të dëmtojnë edhe buxhetin.

Rekomandimi 3 Kryesuesi i KGJK dhe Drejtori i SKGJK, duhet të siguroj se të gjitha shpenzimet në lidhje me kompensimin e takimeve të anëtarëve në këshill dhe komisione të jenë të dokumentuara dhe në pajtim me UA në fuqi.

Çështja 4 - Mbulimi i pozitave me Ushtrues Detyre U.D

E gjetura Neni 30 i LSHC nr.03L/149, përcakton se në rast të mbajtjes së një pozite të lirë në shërbimin civil, ushtruesi i detyrës (U.D) nuk mund të emërohet më gjatë se tre (3) muaj.

Gjatë auditimit për vitin 2017, kemi identifikuar se gjashtë pozita mbulohen me Ushtrues Detyre (UD) mbi afatin e lejuar kohor. Rastet e identifikuara ishin:

- *Zyrtari i lartë në njësinë për Evidencë Penale në SKGJK nga dt.29.12.2015,*
- *Drejtori i Zyrës se Evidencës Qendrore nga dt.01.08.2015,*
- *Zyrtarit Certifikues në Gjykatën Themelore në Gjilan mbulohet me UD nga dt.01.01.2016,*
- *Ndërsa pozita e Udhëheqësit për Buxhet dhe Financa në Gjykatën Themelore të Prishtinës e cila është mbajtur me UD nga dt.28.01.2016, ishte marrë aprovimi nga MF për zhvillimin e procedurave të rekrutimit.*

Rreziku Praktika e mbulimit të pozitave kyçe me U.D për periudha të gjata kohore, përveç se nuk është në pajtueshmëri me legjislacionin në fuqi, rrezikon që pozitat të menaxhohen nga personat që nuk i përmbushin kriteret e nevojshme në mungesë të konkurrencës së hapur. Kjo mund të ndikojë negativisht në performancën e organizatës në përgjithësi.

Rekomandimi 4 Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të sigurojë zhvillimin e procedurave të rekrutimit, që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta. Kohëzgjatja e funksionit si U.D të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.

Çështja 5 – Tejkalim i numrit të Gjyqtarëve për Krime të rënda

- E gjetura** Vendimi i Qeverisë së Kosovës nr. 06/148 i dt. 30.06.2017 për ndarjen e mjeteve financiare sipas nën-programeve për secilën gjykatë lidhur me kompensimin e shtesave dhe stimulimi financiar prej 300€ në muaj për 85 gjyqtarë të krimeve të rënda.
- Gjatë auditimit është identifikuar se në dy gjykata është tejkaluar numri i gjyqtarëve për krimeve të rënda. Gjykata e Apelit me vendim i ka të lejuar 9 gjyqtarë për krime të rënda, ndërsa e njëjta operon me 15 gjyqtarë. Rasti tjetër është në Gjykatën Themelore të Mitrovicës ku me vendim të lejuar i ka shtatë gjyqtarë për krime të rënda, ndërsa e njëjta operon me nëntë gjyqtarë.
- Rreziku** Tejkalimi i numrit të gjyqtarëve rritë rrezikun që të përfitojnë më shumë gjyqtarë se sa që janë të caktuar me vendim si dhe ngarkim i buxhetit të KGJK-së.
- Rekomandimi 5** Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK-së dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të siguroj që vendimet e nxjerra nga Qeveria për stimulimin financiar të gjyqtarëve për krime të rënda të zbatohen në tërësi vetëm për numrin e lejuar të tyre.

3.4 Menaxhimi i personelit

Menaxhimi i personelit përfshin të gjitha veprimet që ndërlidhen me procedurat e rekrutimit, kontratat, trajnimet, avancimet, pushimet, procesin e pensionimit, pushimet e lehonisë, ndalesat dhe masat e ndërmarrura nga KGJK. Ne kemi testuar një numër mostrash për të siguruar se veprimet e ndërmarrura në këtë fushë janë në harmoni me rregulloret e zbatueshme. Për mostrat tona nuk kemi vërejtur ndonjë çështje për t'u raportuar.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime dhe shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 4,333,358€. Prej tyre ishin shpenzuar 3,942,370€. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këto kategori përfshijnë shpenzimet për shërbimet kontraktuese, shërbimet postare dhe shërbimet e telefonisë mobile.

Çështja 6 - Marrëveshjet për shërbime të veçanta

E gjetura Sipas nenit 12 pika 4 e LShC nr.03L/149, emërimet me afat të caktuar për një periudhë më të shkurtër se gjashtë muaj do të bëhen në bazë të kontratave të quajtura “Marrëveshje për shërbime të veçanta” të cilat i nënshtrohen Ligjit për Detyrimet dhe për të cilat zbatohet një procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Ne kemi identifikuar se Gjykata Themelore në Prishtinë kishte lidhur marrëveshjen për shërbime të veçanta me një punonjës për pozitën „Roje Sigurimi” në kohëzgjatje gjashtë muaj, duke vazhduar edhe për gjashtë muaj të tjerë. Pagesa për këto shërbime ishte bërë nga kategoria mallra dhe shërbime (kodi 13420) në shumë 291€ në muaj. Kontrata për shërbime të veçanta është lidhur për pozitë të zakonshme e jo për ekspertë të fushave përkatëse dhe për të njëjtën nuk është zhvilluar procedurë e thjeshtësuar e rekrutimit.

Rreziku Mbulimi i pozitave të zakonshme dhe me kohëzgjatje mbi afatin e përcaktuar përmes procedurave jo adekuate paraqet anashkalim të dispozitave të përcaktuara ligjore, kufizon konkurrencën dhe rritë rrezikun që shërbimet të mos jenë reale me nevojat e KGJK-së dhe se buxheti i planifikuar për këtë kategori të mos shpenzohet sipas qëllimit të caktuar.

Rekomandimi 6 Kryesuesi i KGJK, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të siguroj se marrëveshjet për shërbime të veçanta përdoren vetëm për qëllimin e caktuar, planifikohen drejtë dhe bëhen në pajtim me kërkesat ligjore në fuqi.

3.6 Subvencionet dhe transferet

Buxheti për subvencione dhe transfere ishte 392,532€. Prej tyre në 2017 ishin shpenzuar 385,470€. Kryesisht këto shpenzime kanë të bëjnë me kompensimin e të dënuarave pa bazë. Ne kemi identifikuar një rast (person) i cili kishte qëndruar në paraburgim për 26 ditë sipas vendimit gjyqësor i cili ishte kompensuar 1,385€, për 50 ditë më tepër dhe jo në përputhje me vendimin gjyqësor. Buxheti ishte dëmtuar për 825€. Pas identifikimit të ekipit tonë, kjo çështje është adresuar dhe pagesa e ekzekutuar më tepër është kthyer në buxhetin e KGJK-së.

3.7 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte 710,000€, prej tyre ishin shpenzuar 651,922€. Pjesa më e madhe e shpenzimeve në këtë kategori përfshijnë, riparimin e objekteve të gjykatave, furnizimi dhe montimi i ashensorit.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.8 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte në vlerë 15,878,000€, pasuritë nën 1,000€ ishte në vlerën 1,024,000€, ndërsa stoqet 213,000€. Ne testuam blerjet e vitit 2017, rregullsinë në regjistrimin e pasurisë, si edhe ekzaminimin fizik për të verifikuar ekzistencën e pasurive. Auditimi jonë mbi menaxhimin e pasurisë identifikoi dobësitë e paraqitura më poshtë.

Çështja 7 – Mangësi në menaxhimin e pasurive

- E gjetura** Ne kemi vërejtur se sistemi e-pasuria nuk ishte funksional, për faktin se nuk janë të regjistruara blerjet e vitit 2017 në këto raste; furnizim me inventar në vlerë të faturës së përgjithshme 4,785€, blerja e pajisjeve të IT në bashkëfinancim me projektin SMIL në vlerë 204,14211€. Më tutje, të dhënat në PVF të prezantuara për pasuritë nën 1000€ ishin vlera nga inventarizimi i pasurisë, edhe pse në raportin e inventarizimit nuk ishte shënuar data e blerjes së pasurive, kjo gjë e vështirëson identifikimin se si është kalkuluar zhvlerësimi për vitin. Raporti i inventarizimit përmbante pasuri (jashtë përdorimit dhe të dëmtuar) dhe i njëjti nuk harmonizohet me e-pasuri. Komisioni i vlerësimit të pasurive nuk kishte raport për KGJK sa i përket pasurive të cilat ishin identifikuar si jashtë përdorimit dhe pasurit që duhen të largohen nga përdorimi ose të tjetërsohen. Për më tepër gjendja mbetet e njëjtë me vitin e kaluar në lidhje me sistemin e-pasuri.
- Rreziku** Kontrolllet e dobëta në menaxhimin e pasurisë dhe mosfunksionimi i plotë i sistemit të e-pasurisë, vështirëson menaxhimin dhe kontrollin e pasurive në dispozicion, dhe rrit rrezikun e humbjes dhe keqpërdorimit të pasurive.
- Rekomandimi 7** Kryesuesi i KGJK-së, Drejtori i SKGJK dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse duhet t'i rishikoj kontrollat ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas dhe regjistrimin e gjithë pasurive, në mënyrë që të siguroj largimin e pasurive jashtë përdorimit sipas vlerësimeve të komisionit përkatës dhe të harmonizojnë raportet e vlerësimit dhe inventarizimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasurive në PVF. Në këtë aspekt të ndërmerr veprime konkrete për funksionalizimin e sistemit të e-pasurisë që të gjitha pasuritë nën 1,000€ të regjistrohen në këtë sistem.

3.9 Trajtimi i parasë së gatshme dhe ekuivalentëve të saj

Paraja e gatshme ishte menaxhuar në harmoni me rregullën 01/2013 për shpenzimin e parave publike. Te gjitha transaksionet e parave të imëta ishin regjistruar në llogarinë përkatëse me rastin e arsyetimit të shpenzimeve të bëra nga fondi i parave të imëta.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

¹¹ Faturat në shumë 204,142€ dhe 4,785€ ishin si total, mirëpo pajisjet e IT dhe inventarit që figurojnë në faturë janë në vlerë nën 1000€.

3.10 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme sipas të dhënave në PVF për vitin 2017 ishin 159,000€. Nëse bëjmë një krahasim në raport me vitin e kaluar (2016) shihet një rënie LL/ A për 2,000€. Këto LLA përbëhen nga vendimet e gjykatave të cilat janë të pa realizuara deri në fund të vitit 2017.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

3.11 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 376,454€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Megjithatë, kjo pasqyron vetëm një pjesë të vështirësisë buxhetore të hasur nga KGJK. Krahasuar me vitin 2016 vërehet një ngritje e obligimeve të papaguara për 103,726€ apo 38%. Arsyeja e mos pagesës ishte mungesa e mjeteve financiare.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandim në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të të vitit 2016, ka rezultuar me 11 rekomandime. KGJK kishte përgatitur një Plan Veprimi brenda 30 ditëve pas pranimit të raportit të auditimit, ku paraqitet mënyra se si do t'i zbatohen rekomandimet.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2017, gjashtë rekomandime ishin zbatuar, tre ishin në proces dhe dy nuk ishte zbatuar ende. Ndërsa rekomandimet e bartura nga viti 2015 ishin nëntë, prej tyre gjashtë ishin të zbatuar dhe tre në proces të zbatimit. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 8 - Zbatimi i rekomandimeve nga vitet paraprake

- E gjetura** Niveli aktual i trajtimit të rekomandimeve nuk është i kënaqshëm për shkak se KGJK nuk ka ndjekur ndonjë proces formal për të rishikuar dhe monitoruar mënyrën e zbatimit të rekomandimeve dhe identifikimin e pengesave për veprim në adresimin e tyre të plotë. Një qasje e tillë është e nevojshme për të menaxhuar përmirësim të vazhdueshëm në të gjithë organizatën.
- Rreziku** Mungesa e një monitorimi efektiv të zbatimit të rekomandimeve ka rezultuar në dobësi të vazhdueshme lidhur në fushat pagave dhe shtesave, subvencioneve, si dhe menaxhim të pasurive.
- Rekomandimi 8** Kryesuesi i KGJK-së, Drejtori i SKGJK-së dhe Kryetarët e gjykatave përkatëse, duhet të sigurojë që plani i veprimit rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe mekanizma llogaridhënës ndaj të gjithë personave përgjegjës të ngarkuar për zbatimin e rekomandimeve. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë përfshinë parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisja e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmer veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave

buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzojnë në Ministrinë e Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

KGJK-ja ka përgatitur raportin e menaxhimit të rrezikut duke identifikuar disa rreziqe, mirëpo ato rreziqe nuk ishin konform objektivave të saj.

Një mjet kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit, për të cilat KGJK nuk kishte arrit t'i zbatoj gjitha rekomandimet e viteve të kaluara. Po ashtu, pyetësi i vetëvlerësimit ishte përfunduar me kohë si kërkesë ligjore të parapara me rregullat e MFK-së.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NjAB), përbëhet nga Drejtor i NJAB dhe tre auditorë. NJAB kishte të aprovuar planin vjetor strategjik. NJAB për vitin 2017 ku kishin planifikuar dhe kryer shtatë auditime të rregullta.

Komiteti i auditimit në KGJK përbëhej prej tre anëtarëve dhe mandati i tyre ishte përfunduar në korrik 2017. Ky komitet kishte mbajtur vetëm një takim me dt. 21.06.2017, nga i cili ishte diskutuar shqyrtimi i raportit vjetor të NJAB për vitin 2016, dhe se nga ky takim nuk ishte nxjerrë ndonjë konkluzion për menaxhmentin se çfarë veprimesh duhet të ndërmer për zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga NJAB.

Çështja 9 - Komiteti i Auditimit

E gjetura	Sipas UA nr.11/2010 për themelimin dhe funksionimin e Komitetit të Auditimit në subjektin e sektorit publik, kërkohet që çdo SSP të themeloj KA. Ne kemi vërejtur se KGJK që nga korriku i vitit 2017 nuk ka themeluar KA.
Rreziku	Mos funksionimi i KA rezulton me mos shqyrtim të raporteve të NJAB që rrit rrezikun që menaxhmenti të mos jetë i informuar për të ndërmarrë masat adekuate për çështjet e ngritura nga NJAB.
Rekomandimi 9	Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i SKGJK-së duhet të sigurojë themelimin e komitetit të auditimit.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Menaxhmenti ka zbatuar një sërë kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet financiare funksionojnë siç duhet. Është e rëndësishme që ato të përfshijnë raportimin e duhur tek menaxhmenti për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara.

Në kuadër të KGJK-së operojnë: Sekretariati i KGJK-së (SKGJK), shtatë Gjykata Themelore, Gjykata e Apelit, Gjykata Supreme, Dhoma e Posaçme, Njësia e Shqyrtimit të Përformancës dhe Zyra e Prokurorit Disiplinor. PVF-të e të gjitha njësive konsolidohen në PVF-të e KGJK-së dhe të konsoliduara dërgohen në Thesar si një tërësi. Njësitë e KGJK-së kanë përgjegjësitë e tyre të ndara nga SKGJK të bartura me Udhëzimin Administrativ 01/2015. Procesi i raportimit të brendshëm në KGJK-së funksionon sipas zingjirit llogaridhënës dhe strukturës organizative.

Çështja 10 - Kontrollat menaxheriale dhe menaxhimi i rrezikut

E gjetura Rishikimi ynë i kontrolleve menaxheriale të zbatuara në sistemin kryesor financiar ka nxjerrë në pah mangësi të cilat ndikojnë në zvogëlimin e efektivitetit të menaxhimit financiar në përgjithësi. Me theks të veçantë, kontrollet ishin jo efektive në menaxhim të pasurive.

KGJK kishte arritur të hartoj listën e rreziqeve, mirëpo rreziqet nuk ishin të identifikuar karshi objektivave të organizatës, po ashtu nuk bëhet monitorimi i tyre, si dhe reagimet në rast të ndodhjes së tyre.

Rreziku Mungesa e menaxhimit efektiv të rreziqeve dhe monitorimit të objektivave mund të ndikojnë në mos-arritjen e tyre. Kjo, për shkak se veprimet e nevojshme për të parandaluar ose evituar ndikimin e çështjeve të tilla nuk do të ndërmerren në mënyrë të planifikuar dhe sistematike.

Rekomandimi 10 Kryesuesi i KGJK-së dhe Drejtori i SKGJK-së duhet të sigurojë që hartimi i regjistrit të rreziqeve të jetë në përputhje me objektivat, të delegohet përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar përkatës i cili do të siguroj monitorim dhe raportim në baza të rregullta mbi rreziqet.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitet e mëhershme

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017		Nuk janë ndërmarrë masa
2.3 Rekomandimet e vitit paraprak	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë që është zbatuar plani i veprimit, i rishikuar, i cili i përcakton saktë afatet kohore për implementimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme.		Pjesërisht është bërë zbatim i rekomandimeve, pasi që ende kishte rekomandime të cilat ishin në proces dhe nuk bëhej monitorimi formal i tyre.	
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se kanë hartuar një plan për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve të cilat mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore, si dhe ka caktuar një person përgjegjës për menaxhimin e rrezikut i cili raporton në baza mujore për zbatimin e kërkesave në këtë fushë.		KGJK për vitin 2017 kishte përpiluar një listë të rreziqeve mirëpo nuk bënte monitorimin i saj.	
3.7 Pasuritë kapitale dhe jo-	Kryesuesi i KGJK-së duhet të sigurojë se janë identifikuar shkaqet e mos funksionimit të kontrolleve ekzistuese		KGJK gjatë vitit 2017 kishte bërë përpjekje që ta vë në funksion e-pasurinë mirëpo ende nuk ishte	

kapitale.	në këtë fushë, dhe të ndërmerren veprimet e duhura që sistemi e-pasuria të futet sa më shpejtë në përdorim. Në rast nevojë zyrtarëve përgjegjës t'ju ofrohen trajnimet e nevojshme në përdorimin e aplikacionit e-pasuria.		funksionalizuar.	
Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të siguroj se është bërë një analizë edetajuar e shkaqeve, për theksimin e çështjes. Në këtë aspekt, të ndërmerren veprimet e duhura që e gjithë pasuria të regjistrohet dhe t'i nënshtrohen zhvlerësimit duke aplikuar normat përkatëse të tyre. Me tutje, menaxhmenti duhet të bëjë një rishikim detaj të draft PFV-ve, me fokus të veçantë në fushat me rrezik të lartë dhe/ose fushat ku janë identifikuar gabime.		Për kundër përpjekjeve KGJK ende kishte probleme me regjistrimin e pasurive.	
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se në vazhdimësi është duke e monitoruar progresin e planit të veprimit nga personat përgjegjës për zbatimin e plotë të rekomandimeve të			Nuk ishte zbatuar.

	AP-së, brenda afateve kohore të përcaktuara. Veprime shtesë të ndërmerren ndaj barrierave të paraqitura gjatë zbatimit të këtyre rekomandimeve.			
2.2 Pyetësi i vet-vlerësimit të komponentëve të MFK-së	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se janë ofruar informacione të plota rreth funksionimit të MFK-së. Plotësimi i pyetësit duhet përcillet me mekanizëm të rishikimit për konfirmimin e saktësisë së të dhënave të prezantuara. Më tutje, duhet siguruar hartimi i planit për identifikimin, vlerësimin dhe evitimin e rreziqeve që mund të paraqiten gjatë realizimit të objektivave strategjike dhe vjetore.		KGJK për vitin 2017 kishte përpiluar një listë të rreziqeve mirëpo nuk bëhej monitorimin i saj si dhe nuk ishin rreziqet të cilat i mbulojnë objektivat si dhe pyetësi i vetëvlerësimit nuk paraqiste gjendjen reale.	
2.4 Sistemi i auditimit të brendshëm	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë bashkëpunim të ngushtë mes menaxhmentit, KA-së dhe NJAB-së për identifikimin e dobësive të kontrolleve të brendshme dhe ndërmarrjen e veprimeve adekuate për zbatimin e rekomandimeve.	Është zbatuar.		
3.1.1 Pagat dhe mëditjet	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të ndërmerr veprime për të ndërprerë			Nuk ishte zbatuar.

Çështja 5 - Plotësimi i pozitave me ushtrues detyre më gjatë se tre muaj	praktikat e mbulimit të pozitive me U.D, si dhe të iniciohen procedurat e rekrutimit në mënyrë që këto pozita të plotësohen me kontrata të rregullta sipas përcaktimit ligjor.			
3.1.1 Pagat dhe mëditjet Çështja 6 - Mospërputhje e vendimit për kompensimet me Ligjin e Punës	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë se vendimi për kompensime për punë jashtë orarit të jetë në harmoni me rregullat e përgjithshme dhe parimet e Ligjit të punës 03/L-212, për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera.	Është zbatuar.		
3.1.1 Pagat dhe mëditjet Çështja 7 - Dobësi në procedurat e rekrutimit	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë proces transparent dhe efektiv të rekrutimit të punonjësve duke respektuar të gjitha kërkesat ligjore përfshirë procedurat dhe afatet e parapara.	Është zbatuar.		
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale Çështja 8 - Tejkalim i shpenzimeve të planifikuara për	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë që mjetet shpenzohen sipas planit dhe prioriteteve, për qëllime të rritjes së efikasitetit dhe performancës së organizatës. Mjetet e taksapaguesve të shpenzohen me kujdes të shtuar për tu ofruar atyre shërbime sa më	Është zbatuar.		

udhëtime zyrtare	cilësore.			
3.1.2 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale Çështja 9 - Zotimi dhe urdhërblerja, pas pranimit të faturës	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor i KGJK duhet të sigurojë që blerjet të bëhen vetëm atëherë kur ekzistojnë fondet, respektivisht çdo furnizimi t'i paraprijë urdhër blerja. Furnizimet dhe procesimi i pagesave të bëhet në pajtueshmëri të plotë me hapat e përcaktuara me LMFPF-në dhe me rregullat e Thesarit.	Është zbatuar.		
3.2.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë që janë ndërmarr të gjitha masat për të adresuar problemet që në vazhdimësi po e përcjellin sistemin epasuria në mënyrë që raportimi i pasurive të jetë i saktë dhe i plotë.		KGJK gjatë vitit 2017 kishte bërë përpjekje që ta vë në funksion epasurinë, mirëpo ende ishte në proces të funksionalizimit të këtij programi.	
3.3 Obligimet e papaguara	Kryesuesi i Këshillit Gjyqësor duhet të sigurojë kontrollë shtesë sa i përket raportimit të saktë dhe me kohë të obligimeve sipas kërkesave të rregullës së Thesarit dhe të përcillen rregullisht derisa ato të paguhën.	Është zbatuar.		

Shtojca III: Letërkonfirmimi



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 dhe për implementimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data:

Prishtinë, 06.06.2018

I nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për Auditimin e Raportit Financiar të KGJK-së për periudhën 01.01.2017 deri më 31.12.2017 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Drejtori i Sekretariatit:

Shkëlzen Maligj

për 